



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC
01 Nr. 400/01-7622
13/02/2024

Komuna e Drenasit



Islamic Relief Kosova

Marrëveshje bashkëpunimi / Agreement

Ndërmjet / Between

Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office

dhe / and

Komuna e Drenasit / Municipality of Drenas

Për realizimin e projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) dhe Komuna e Drenasit (Komuna) në lidhje me bashkimin e mjeteve/fondeve për projektin Projekti i Integruar afatgjatë – Një rrugë drejt zhvillimit në Komunën e Drenasit që është pjesë e projektit të IRW me pin kod numër 020_004574 përkrahur nga zyra e Islamic Relief në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USA).

For the realization of the humanitarian project through the service of conditions between Islamic Relief Worldwide - office in Kosovo (IRW) and the Municipality of Drenas regarding the join of funds / donations for the project Long term Integrated Project – A path to Development for the Municipality of Drenas which is part of the IRW project with pin code number 020_004574 supported by Islamic Relief office in USA.

Neni 1 Qëllimi i marrëveshjes

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përcaktojë formën e bashkëpunimit mes IRW dhe Komunës me qëllim të implementimit dhe finalizimit të projektit që ka për qëllim subvencionimin e fermerëve në Komunën e Drenasit me motokultivatorë, sera, shpërndarës plehu artificial dhe spërkatëse.

1.2 Përfitues nga ky projekt do të janë banorët e Komunës së Drenasit.

Neni 2 Përshkrimi i projektit

Article 1 Purpose of the agreement

1.1 The purpose of this agreement is to determine the form of cooperation between IRW and the Municipality in order to implement and finalize the project that aims to support farmers with subvention for motor cultivators, greenhouses, artificial fertilizer spreaders and sprinklers in Municipality of Drenas.

1.2 Beneficiaries of this project will be residents of the Municipality of Drenas.

Article 2 Project description

<p>2.1 Menaxhues i projektit është IRW në bashkëpunim me Departamentin pë Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe participimi i Komunës do të bëhet me anë të transferit të mjeteve të komunës në llogarinë bankare të IRW, NLB 1708200008014285, pas nënshkrimit të marrëveshjes, pastaj IR do të dëshmoj faturat e shpenzimeve dhe raportit të shërbimeve të ofruara.</p> <p>2.2 Procedura e selektimit të fermerëve të cilët do të janë përfitues të subvencioneve do të organizohet nga IRW me komision për selektimin e fermerëve në bazë të kriterieve të krijuara nga Komuna së bashku me Islamic Relief Kosova. Fondet e Komunës do të transferohen në IRW Kosova, pas nënshkrimit të marrëveshjes, me qëllim të startimit të punëve, për projektin dhe fondet e zotuara të parapara në projekt për vitin 2024/2025.</p> <p>2.3 Monitorimin, organizimin si dhe raportimin për kuantitetin si dhe kualitetin e shërbimeve do ta bëjë koordinatori/mbikëqyrësi i projektit i cili do të jetë në bashkëpunim të rregullt me Komunën.</p>	<p>2.1 The project is managed by IRW in cooperation with the Department of Agriculture and Rural Development and the municipality's participation will be made by transferring the municipality's funds to the bank account of IRW NLB 1708200008014285, after signing the agreement, then IR will prove the invoices of the expenses and the report of the services provided.</p> <p>2.2 Procedures for selecting farmers which will be beneficiaries of subvention, will be organized by the IRW with the Commission for the Selection of farmers based on criteria established by the Municipality together with Islamic Relief Kosova. Municipal funds will be transferred to IRW Kosovo, after signing the agreement in order to start work, for the project and the committed funds provided in the project for 2024/2025.</p> <p>2.3 Monitoring, organization and reporting on the quality and quality of services should be done by the project coordinator/supervisor who will be in regular cooperation with the Municipality.</p>
<p>Neni 3 Obligimet e palëve</p> <p>3.1 Participimi financiar</p> <p>3.1.1 Në kuadër të projektit me pin kod 020_004574 IRW do të sigurojë pjesën e fondevës në vlerë prej 58,913.00 € (pesëdhjetë e tetë mijë e nentëqind e trembëdhjetë euro) ose 49.54% të vlerës totale për implementimin e këtij projekti.</p> <p>3.1.2 Në kuadër të buxhetit Komunal, Komuna do të participojë me kontribut financiar në shumën prej 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro) ose 25.23% të vlerës totale për implementimin e këtij projekti ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.</p> <p>3.1.3 Fermerët përfitues të secilës komponentë, do të participojnë me 30% të vlerës së komponentës përfituese. Kjo vlerë totale llogaritet të jetë 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro) ose 25.23% të vlerës totale për implementimin e këtij projekti ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.</p> <p>3.1.4 Total vlera e projektit është 118,913.00 € (njëqind e tetëmbëdhjetë e nentëqind e trembëdhjetë euro), duke përfshirë fondet nga ana e Islamic Relief Kosova,</p>	<p>Article 3 Obligations of the parties</p> <p>3.1 Financial participation</p> <p>3.1.1 Within the project with pin code 020_004574 IRW will provide part of the funds in the amount of 58,913.00 € (fifty eight thousand nine hundred and thirteen euros) or 49.54% of the total value for the implementation of this project.</p> <p>3.1.2 Within the Municipal budget, the Municipality will participate with a financial contribution in the amount of 30,000.00€ (thirty thousand euros) or 25.23% of the total value for the implementation of this project as presented in Annex A of this Agreement.</p> <p>3.1.3 Beneficiary farmers of each component will participate with 30% of the value of the beneficial component. This total value is calculated to be €30,000.00 (thirty thousand euros) or 25.23% of the total value for the implementation of this project as presented in Appendix A of this Agreement.</p> <p>3.1.4 The total value of the project is €118,913.00 (one hundred and eighteen nine hundred and thirteen euros), including funds from Islamic Relief Kosovo, the</p>



<p>Komuna e Drenasit dhe participimin e fermerëve ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.</p>	<p>Municipality of Drenas and the participation of farmers as presented in Appendix A of this Agreement.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Përgjegjësitë e palëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Responsibilities of the parties</p>
<p>4.1 Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përmbushur përgjegjësitë sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse në çdo kohë komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas Marrëveshjes, menjëherë do të njoftojë IRW - Koordinatoren e Programit si dhe e kundërtë.</p>	<p>4.1 It is understood by both parties to this Agreement that each party must be capable of fulfilling its responsibilities under this Agreement. If at any time the municipality is unable to perform its functions under the Agreement, it shall immediately notify IRW - Program Coordinator and vice versa.</p>
<p>4.2 Të dyja palët bien dakord për të emëruar koordinatorët për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje.</p>	<p>4.2 Both Parties agree to appoint coordinators for the successful implementation of this Agreement.</p>
<p>4.3 Koordinatorët do të janë përgjegjës për rolet e institucionit të tyre dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.</p>	<p>4.3 The Coordinators shall be responsible for the roles of their Institution and for ensuring the successful implementation of the articles of this Agreement.</p>
<p>4.4 Personi kontaktues i caktuar nga Komuna pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje si dhe personi kontaktues i caktuar nga IRW pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje.</p>	<p>4.4 The Contact Person designated by the Municipality agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement and the Contact Person designated by IRW agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Koordinatorët</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Coordinators</p>
<p>6.1 Koordinatori për IRW Emri: Albulena Gashi Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, NO. 10 / A Prishtinë, Republika e Kosovës Zyra Telefon: 038/232-431 / mob.044/454-136 Email: albulena.gashi@ir-rks.org</p>	<p>6.1 IRW Coordinator Name: Albulena Gashi Address: Bajram Kelmendi Street, NO. 10 / A Pristina, Republic of Kosovo Office Phone: 038/232-431 / mob.044/454-136 Email: albulena.gashi@ir-rks.org</p>
<p>6.2 Koordinatori për Komunën Emri: Adresa: Telefoni: Tel/Fax: Email:</p>	<p>6.2 Coordinator for the Municipality Name: Address: Phone: Tel / Fax: E-mail:</p>

5300055-3

<p>Neni 6 Gjuha zyrtare e marrëveshjes</p> <p>7.1 Gjuha që mbizotëron në këtë marrëveshje është versioni në Gjuhën shqipe.</p> <p>Neni 8 Kohëzgjatja e marrëveshjes</p> <p>8.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të Drejtorit për Kosovë të Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë, dhe kryetarit të Komunës së Drenasit, dhe do të vazhdojë deri më 1 dhjetor 2025 ku pritet edhe të përfundojë realizimi i projektit.</p> <p>Neni 9 Mosmarrëveshjet</p> <p>9.1 Në rast të ngecjeve të realizimit të projektit palët pajtohen që të bëjnë ndryshimin e kësaj marrëveshjeje për një periudhë tjeter me aneks të ri të kësaj marrëveshje me shkrim dhe të nënshkuar nga të dyja palët.</p>	<p>Article 6 Official language of the agreement</p> <p>7.1 The language prevailing in this Agreement is the Albanian language version.</p> <p>Article 8 Duration of the agreement</p> <p>8.1 This Agreement shall enter into force upon signature of the Director for Kosovo of the Islamic Relief Worldwide office in Kosovo, and the Mayor of Drenas, and shall continue until 31st of October, 2024 when the implementation and monitoring of the project is expected to be completed.</p> <p>Article 9 Disputes</p> <p>9.1 In the event of project implementation delays, the Parties agree to amend this Agreement for another period with a new Annex to this Agreement in writing and signed by both parties.</p>
--	--

Islamic Relief Worldwide – Kosova Office



Dr. Mohamed Soliman

Country Director Islamic Relief Kosova

Data/Date: 13-2-2024

Komuna e Drenasit / Municipality of Drenas



Z. Ramiz Lladrovci

Kryetar / Mayor

Data/Date: 13/02/2024

Description Përshtimi	IRW - Kosovo Office and Municipality of Drenas				IRW - Kosovo Office				Municipality of Drenas				Beneficiaries' participation	
	Units Njesi	Unit price çmimi për njësi	Total Total	Units Njesi	Unit price çmimi pér njësi	Total Total	Units Njesi	Unit price çmimi pér njësi	Total Total	Units Njesi	Unit price çmimi pér njësi	Total Total		
Participimi														
Fertilizer spreader	67	345.52	23,149.96	33.28	345.52	11,499.96	10.27	345.52	3,550.00	23.44	345.52	3,455.72		8,100.00
Sprayer of land medicine	67	650.00	43,550.00			-	37	650.00	24,050.00	30	650.00	19,500.00		
Greenhouses one per Family	10	1,230.00	12,300.00	10	1,230.00	12,300.00			-					-
Multicultivator tractor	76	400.00	30,400.00	76	400.00	30,400.00			-					-
Indirect - Monitoring and evaluation costs	1	9,513.04	9,513.04	1	4,713.04	4,713.04	1	2,400.00	2,400.00	1	2,400.00	2,400.00		
Totals:		118,913.00		Totals:	58,913.00		Totals:	58,913.00		Totals:	30,000.00		Totals:	30,000.00